

## Thekset nga përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim

- Dokumenti nuk ka përqasjen e një strategjie ne kuptimin klasik – po bazohet kryesisht **ne një numër te kufizuar prioritetesh** qe synojnë:
  - lehtësimin apo eliminimin e pengesave qe kufizojnë rritjen ekonomike, ose
  - shfrytëzimin me efektiv te resurseve te pa shfrytëzuara, ne funksion te rritjes ekonomike.
- Simbolikisht mund ti konsiderojmë si **“prioritet i prioriteteve”**
- **Kriteri i pare** i përzgjedhjes është qe prioritetet e Strategjisë **te kenë një impakt te drejtpërdrejt ne rritjen ekonomike te Kosovës**
- **Kriteri i dyte** i rëndësishëm për përzgjedhjen e këtyre prioriteteve është fokusimi i tyre tek **reformat strukture**. Pritshmëria është qe zbatimi këtyre masave te gjenerojne një efekt sistemik ne ekonomi dhe ne shumicën e rasteve nder-sektorial ne funksion te promovimit te rritjes ekonomike.
- **Po pse vetëm një numër i kufizuar prioritetesh** ? Kjo për arsye se **burimet janë te kufizuara** dhe Qeveritë qe do te mbështesin zbatimin e kësaj Strategjie do te duhet te prioritarizojne financimin e atyre masave qe janë me efektive nga këndvështrimi i impaktit ne rritjen ekonomike e rrjedhimisht zhvillimin Kosoves.
- Simbolikisht – prioritete e kësaj strategjie mund te quhen edhe **“prioritetet e Kryeministrit”** apo nivelit te larte te qeverisjes dhe do te duhet te raportohen e monitorohen ne ketë nivel.
- **Po prioritet e tjera** ? Padyshim qe ka prioritete qe ngelen jashtë kësaj strategjie qe janë shume te rëndësishme. Këto prioritete do te duhet te adresohen ne kuadër te **Strategjive Sektoriale**. Simbolikisht këto mund ti quajmë **“prioritete te sektorit”**. Monitorimi i tyre do te behet ne nivel sektorial.
- Prioritet e para do te **dominojnë ne procesin e planifikimit te resurseve** dhe aktiviteteve te institucioneve te Kosovës ne vitet qe vijnë - si nga burimet e KASH ashtu edhe financimet e donatoreve.
- Sa me sipër do te mbështetet edhe nga sistemi i planifikimit dhe monitorimit te integruar qe institucionet e Kosovës do te adoptojnë gradualisht – nen udhëheqjen e ZKM.